

## REKTORI SADI BEXHETI MYSAFIR I UNIVERSITETIT TË SHUTGARTIT

Në Universitetin e Shtutgartit të Gjermanisë po qëndron në një vizitë rektori i Universitetit Shtetëror të Tetovës, prof. dr. Sadi Bexheti.

Vizita e rektorit të USHT-së Sadi Bexheti në Universitetin e Shtutgartit bëhet në kuadër të Projektit për unifikimin e proceseve në katër Universitetet e Maqedonisë. Pritet që rektori Bexheti në Shtutgart të marrë certifikatën “Iso 9001”.



Gjatë vizitës që po bën në kuadër të Projektit “Tempus” me emërtim **QUALIMUM (Quality Management at Universities in Macedonia)**, rektori u takua me prorektorin për strukturim organizativ të Universitetit të Shtutgartit, prof. Weigand. Me këtë rast, ai u informua për zhvillimin e procesit mësimor në këtë universitet dhe për mundësinë e një bashkëpunimi ndëruniversitar.

Rektori Sadi Bexheti, shfrytëzoi rastin për të prezantuar USHT-në dhe vizionin e tij për këtë institucion të lartë arsimor të shqiptarëve në Maqedoni. Ai u angazhua për një intensifikim të bashkëpunimit me universitetet gjermane, si dhe për shkëmbimin e kadrove dhe studentëve të këtyre dy institucioneve të larta arsimore.